FASHION
GROUP ALBANIA

Fashion Group Albania

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2017

INDIVIDUALE

Përmbajtja

PASQYRAT FINANCIARE

1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR 2
2. PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE) 4
3. PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE 5
4. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE 6
5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL 7

SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME 8
2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANICIARE 8
3. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME 9
4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL 9
5. MJETE MONETARE 14
6. TË ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT 14
7. TE ARKETUESHME NGA NJESITE EKONOMIKE BRENDA GRUPIT 15
8. TË DREJTA TË ARKËTUESHME TË TJERA 15
9. INVENTAR –LENDE E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME 16
10. INVENTARE-MALLRA 16
11. INVENTARE-PARAPAGIME 16
12. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA 16
13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE 17
14. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE 18
15. HUA AFATSHKURTER 18
16. ARKËTIME NË AVANCË PËR POROSI 18
17. TË PAGUESHME AFATSHKURTRA PËR AKTIVITETIN E SHFRYTËZIMIT 18
18. TË PAGUESHME NDAJ NJËSIVE EKONOMIKE BRENDA GRUPIT 19
19. TË PAGUESHME PËR DETYRIMET TATIMORE 19
20 DETYRIME AFATGJATA NDAJ INSTITUCIONEVE TË KREDISË 20
21. KAPITALI I NËNSHKRUAR 20
22. REZERVA TE TJERA 20
23. FITIM/HUMBJA E VITIT FINANCIAR 20
24. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT 21
25. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT 21
26. NDRYSHIMET NË INVENTARIN E PRODUKTEVE TE GATSHME DHE TE PRODUKETEVE NE PROCES 21
27. SHPENZIME TE PERSONELIT 21
28. SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT 22
29. SHPENZIMET NGA INTERESI 22
30. FITIM (HUMBJET) NGA KURSI I KEMBIMIT 22
31. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN 23
32. PALET E LIDHURA 23
33. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT 23

1. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR[1]

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) 31 Dhjetor 2017			në lekë	
	Zëri i Bilancit	Shënime	2017	2016
A	**AKTIVET**		**661,663,440**	**865,300,708**
I	**Aktivet Afatshkurtra**		**468,792,939**	**662,852,230**
1	**Mjete monetare**	5	**133,589,900**	**133,101,851**
2	**Investime :**		-	-
a)	*Në tituj pronësie të njësive ekonomike brenda grupit*		-	-
b)	*Aksionet e veta*		-	-
c)	*Të tjera financiare*		-	-
	Totali		-	-
3	**Të drejta të arkëtueshme :**			
a)	*Nga aktiviteti i shfrytëzimit*	6	2,946,623	23,130,184
b)	*Nga njësitë ekonomike brenda grupit*	7	63,985,898	73,514,065
c)	*Nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
d)	*Të tjera*	8	3,059,427	879,506
e)	*Kapital i nënshkruar i papaguar*		-	-
	Totali		**69,991,948**	**97,523,756**
4	**Inventarët:**			
a)	*Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme*	9	-	28,710,534
b)	*Prodhime në proces dhe gjysëmprodukte*		-	-
c)	*Produkte të gatshme*		-	-
d)	*Mallra*	10	260,256,973	391,360,026
e)	*Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri)*		-	-
f)	*AAGJM të mbajtura për shitje*		-	-
g)	*Parapagime për inventar*	11	1,772,642	-
	Totali		**262,029,615**	**420,070,560**
5	**Shpenzime të shtyra**	12	**3,181,477**	**12,156,064**
6	**Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara**			-
	I-Aktive totale afatshkurtra		**468,792,939**	**662,852,230**
II	**Aktive Afatgjata**		**192,870,501**	**202,448,477**
1	**Aktive financiare:**		-	-
a)	*Tituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit*		-	-
b)	*Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupit*		-	-
c)	*Tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
d)	*Tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
e)	*Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata*		-	-
f)	*Tituj të tjerë të huadhënies*		-	-
	Totali		-	-
2	**Aktivet materiale:**			
a)	*Toka dhe ndërtesa*		-	-
b)	*Impiante dhe makineri*	13	40,474,542	47,576,218
c)	*Të tjera Instalime dhe pajisje*	13	151,994,559	154,872,259
d)	*Parapagime për aktive materiale dhe në proces*		-	-
	Totali		**192,469,101**	**202,448,477**
3	**Aktive Biologjike**		-	-
4	**Aktive jo materiale:**			-
a)	*Koncesione, patenta, licenca, marka tregtare, të drejta dhe aktive të ngjashme*		-	-
b)	*Emri i Mirë*			
c)	*Parapagime për AAJM*	14	401,400	-
	Totali		**401,400**	-
5	**Aktive tatimore të shtyra**		-	-
	II-Aktive totale afatgjata		**192,870,501**	**202,448,477**
	Aktive totale (I+II)		**661,663,441**	**865,300,707**

[1]Kjo pasqyre te lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga numri 1 deri 34, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

1. Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) 31 Dhjetor 2017			në lekë	
	Zëri i Bilancit	Shenime	31.12.2017	31.12.2016
B	DETYRIME DHE KAPITALI		661,663,441	865,300,707
I	Detyrimet afatshkurtra		571,240,430	810,260,287
1	Detyrime afatshkurtra:		571,240,430	810,260,287
a)	*Titujt e huamarrjes*		-	-
b)	*Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*	15	9,306,500	9,466,100
c)	*Arkëtimet në avancë për porosi*	16	2,383,900	2,185,885
d)	*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*	17	460,291,289	679,329,559
e)	*Dëftesa të pagueshme*		-	-
f)	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*	18	68,627,821	102,701,195
g)	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
h)	*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore*			
i)	*Të pagueshme për detyrimet tatimore*	19	30,630,920	16,577,549
j)	*Të tjera të pagueshme*			
	Totali		571,240,430	810,260,287
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
3	Të ardhura të shtyra		-	-
4	Provizione			-
	I-Totali i Detyrimeve afatshkurtra		571,240,430	810,260,287
II	Detyrime afatgjata		571,240,430	810,260,287
1	Detyrime afatgjata:		302,551,821	295,266,108
a)	*Titujt e huamarrjes*		-	-
b)	*Detyrime ndaj institucioneve të kredisë*	20	5,428,797	15,309,061
c)	*Arkëtimet në avancë për porosi*		-	-
d)	*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit*		-	-
e)	*Dëftesa të pagueshme*		-	-
f)	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit*			-
g)	*Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse*		-	-
j)	*Të tjera të pagueshme*		-	-
	Totali		5,428,797	15,309,061
2	Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
3	Të ardhura të shtyra		-	-
4	Provizione:		-	-
a)	*Provizione për pensionet*		-	-
b)	*Provizione të tjera*		-	-
	Totali		-	-
5	Detyrime tatimore të shtyra		-	-
	II-Totali i Detyrimeve afatgjata		5,428,797	15,309,061
	Detyrime totale(I+II)		576,669,226	825,569,348
III	Kapitali dhe Rezervat		84,994,216	39,731,359
1	Kapitali i Nënshkruar	22	86,600,000	86,600,000
2	Primi i lidhur me kapitalin		-	-
3	Rezerva rivlerësimi		-	-
4	Rezerva të tjera		21,106,592	21,106,592
a)	*Rezerva ligjore*		-	-
b)	*Rezerva statutore*		-	-
c)	*Rezerva të tjera*	23	21,106,592	21,106,592
5	Fitimi i pashpërndarë		(67,975,234)	(41,959,579)
6	Fitim / Humbja e Vitit	24	45,262,858	(26,015,654)
	III-Totali i Kapitalit		84,994,216	39,731,359
	TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		661,663,441	865,300,707

FASHION GROUP ALBANIA sh.p.k. K51914011O

2. PASQYRA E PERFORMANCËS (PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE)[2]

N.r.	PËRSHKRIMI	Shenime	në lekë	
			Viti 2017	Viti 2016
1	Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	25	**1,155,491,065**	**1,075,285,161**
2	Ndryshimi në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces		-	-
3	Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar			
4	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	26	**231,583**	**105,858**
5	Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	27	**(805,693,409)**	**(852,422,537)**
a)	*Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme*		(805,693,409)	(852,422,537)
b)	*Të tjera shpenzime*			
6	Shpenzime të personelit	28	**(83,307,153)**	**(68,261,521)**
a)	*Paga dhe shpërblime*		(72,050,347)	(59,133,052)
b)	*Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore (paraqitur veçmas nga shpenzimet për pensionet)*		(11,256,806)	(9,128,469)
c)			-	-
7	Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale			-
8	Shpenzime konsumi dhe amortizimi		**(49,181,385)**	**(54,369,580)**
9	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	29	**(175,488,228)**	**(122,059,633)**
10	Të ardhura të tjera		-	-
a)	*Të ardhura të tjera të shfrytëzimit*		-	-
b)	*Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*		-	-
c)	*Të ardhura nga investimet dhe huatë e tjera pjesë e aktiveve afatgjata (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*		-	-
d)	*Interesa të arkëtueshëm dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit)*		-	-
11	Zhvlerësimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare të mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
12	***Shpenzime financiare***		**9,725,331**	**(4,293,402)**
a)	*Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme (paraqitur veçmas shpenzimet për t'u paguar tek njësitë ekonomike brenda grupit)*	30	(5,003,674)	(7,912,008)
b)	*Shpenzime të tjera financiare*			-
c)	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit	31	14,729,005	3,618,606
13	Pjesa e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			-
	Fitimi/Humbja para tatimit		**51,777,804**	**(26,015,654)**
14	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(6,514,946)	-
a)	*Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin*	32	(6,514,946)	-
b)	*Shpenzimi i tatim fitimit të shtyrë*			
c)	*Pjesa e tatim fitimit të pjesëmarrjeve*			
	Fitimi/Humbja e vitit		**45,262,858**	**(26,015,654)**
	Fitimi/Humbja për:			
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		45,262,858	(26,015,654)
	Interesat jo-kontrolluese			-

[2] Pasqyrat e performancës lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga numri 1 deri 34, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

3. PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

N.r.	PËRSHKRIMI	Shënime	në lekë	
			Viti 2017	Viti 2016
1	**Fitimi/Humbja e vitit**		**(45,262,858)**	**(26,015,654)**
2	**Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:**		-	-
a)	*Diferencat (+/-) nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja*		-	-
b)	*Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale*		-	-
c	*Diferencat (+/-) nga rivlerësimi i aktivet financiare të mbajtura për shitje*		-	-
d	*Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet*		-	-
	Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin			-
3	**Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin**		-	-
4	**Totali i të ardhurave/humbjeve gjithëpërfshirëse për:**		**(45,262,858)**	**(26,015,654)**
	Pronarët e njësisë ekonomike mëmë		**(45,262,858)**	**(26,015,654)**
	Interesat jo-kontrolluese			-

FASHION GROUP ALBANIA sh.p.k K51914011O

4. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

3. Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare				
Sipas metodës direkte . Direct method			në lekë	
N.r.	P Ë R SH K R I M I	Shenime	Viti 2017	Viti 2016
A	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit**			
1	Të arkëtuara nga të drejtat e arkëtueshme		1,470,797,417	1,270,861,736
2	Të paguara për detyrimet e pagueshme dhe detyrimet ndaj punonjësve		(1,127,686,332)	(920,349,014)
3	Pagesa të tjera		(270,687,519)	(432,444,335)
4				
	Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit		**72,423,566**	**(81,931,614)**
5	Interesi i paguar - Interest paid			-
6	Tatim fitimi i paguar - Taxtion paid			-
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		**72,423,566**	**(81,931,614)**
B	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit**			
1	Para neto të përdorura për blerjen e filialeve			
2	Para neto të arkëtuara nga shitja e filialeve			
3	Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(10,892,875)	-
4	Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale			
5	Pagesa për blerjen e investimeve të tjera			
6	Arkëtime nga shitja e investimeve të tjera			
7	Dividentë të arkëtuar - Dividends received			
8				
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		**(10,892,875)**	-
C	**Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit**			
1	Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar			
2	Arkëtime nga emetimi i aksioneve të përdorura si kolateral			
3	Hua të arkëtuara			60,835,001
4	Pagesa e kostove të transaksionit që lidhen me kreditë dhe huatë			
5	Riblerje e aksioneve të veta			
6	Pagesa e aksioneve të përdorura si kolateral			
7	Pagesa e huave		(70,865,875)	(19,587,784)
8	Pagesë e detyrimeve të qirasë financiare			
9	Interesi i paguar - Interest paid		(5,003,674)	(7,912,008)
10	Dividendë të paguar - Dividends paid			
	Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		**(75,869,549)**	**33,335,209**
	Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		**(14,338,858)**	**(48,596,404)**
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare ne fillim te periudhes kontabel		133,101,851	148,363,046
8	Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		14,826,908	
	Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare ne fund te periudhes kontabel		**133,589,900**	**133,101,851**

FASHION GROUP ALBANIA sh.p.x

5. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Në një pasqyrë individuale të pakonsoliduar

					në lekë		
P Ë R SH K R I M I	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali	Interesa Jo-Kontrollues	Totali
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2015	86,600,000	21,106,592	(55,831,708)	13,872,128	65,747,012	-	65,747,012
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-	-	-	-		-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2016	86,600,000	21,106,592	(55,831,708)	13,872,128	65,747,012	-	65,747,012
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:							-
Fitimi / Humbja te mbartura			13,872,128	(13,872,128)	-		-
Fitimi / Humbja e vitit				(26,015,654)	(26,015,654)		(26,015,654)
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	86,600,000	21,106,592	(41,959,580)	(26,015,654)	39,731,358	-	39,731,358
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017	86,600,000	21,106,592	(41,959,579)	(26,015,654)	39,731,358	-	39,731,358
Fitimi / Humbja te mbartura			(26,015,654)	26,015,654	-		-
Fitimi / Humbja e vitit				45,262,858	45,262,858		45,262,858
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-		-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2017	86,600,000	21,106,592	(67,975,233)	45,262,858	84,994,215	-	84,994,215

FASHION GROUP ALBANIA sh.p.k. K51914011O

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017

1. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqëria **Fashion Group Albania Shpk**, me NUIS K51914011O, eshte krijuar me date 23 Qershor 2005 me Vendim te Gjykates se Shkalles Pare Tirane Nr. 33742 dhe eshte regjistruar ne regjistrin e shoqerive tregtare ne te njejten dite, me kapital te nenshkruar prej 100.000 leke, me ortak te vetem "Balfin 'shpk, me kapital te nenshkruar prej **86'600'000 leke**, qe perbehet nga 86,600 pjese. Administrator eshte Znj.Eva Kallavaresi, me afat emerimi nga 01.03.2018-01.03.2023.
Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte; Importi - eksporti, shitja me shumice e pakice e produkteve tekstile,veshjeve te te gjitha llojeve, etj, te percaktuar ne statutin e saj.

Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresen: Autostrada Tiranë - Durrës, Km 0,
Mbikalimi i Kamzës, Terminal Center, Tiranë, Shqipëri.

Vendi te tjera te ushtrimit te aktivitetit te kesaj shoqerie jane : ne Qendren Tregetare Univers (QTU), Tirana East Gate (TEG), Durrës dhe Tiranë, Fashion Group Albania Shpk zoteron keto njesi tregtimi sic vijojne : Terranova TEG, Parfois QTU, Parfois TEG, Geox QTU, Geox TEG, Mango QTU, Mango TEG, Golden QTU, Golden Tirane, Golden TEG, Golden Durres, Springfield TEG, Prenatal TEG, Carpisa TEG, Carpisa Tiranë, Okaid QTU, Okaidi TEG, Okaidi Tiranë, Cortefiel TEG, Woment Secret.

2. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANICIARE

Shoqeria i mban te dhenat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 2017 në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.
Pasqyrat finaciare janë përgatitur në bazë të kostos historike.
Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.
Aktivet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e te ardhurave gjithpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i shoqërisë ka kryer një vlerësim të aftësisë së shoqërisë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që shoqeria ka burime për të vazhduar biznesin dhe aktivitetin në të ardhmen. Gjithashtu, drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi mundësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

3. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.
Vleresimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilen vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktur për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njeh detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

4. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës se raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2017 është 1 Euro me 132.95 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përvec diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monëdhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monëdhë të huaj.

(b) Instrumentat financiare

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlere neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

Mjetet monetare dhe ekujvalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me nje maturitet tre mujor ose me pak. Per qellime te pasqyres se flukseve monetare, mjetet monetare dhe equivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra te percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënieve bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interest efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e kostos së amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimive të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skonton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuara përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogaritëe pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interest efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.*Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet aftagjata investimi maten me modelin e kostos. Aktivet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrët shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po

llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive afatgjata material

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve aftagjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvëndësimin e një pjese të aktivit afatagjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi
Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose çdo kosto tjetër zëvëndësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

a)	Ndërtesa	5 %
b)	Instalime Teknike	10%
c)	Moblije dhe Paisje zyre	20%
d)	Pajisje informatike	25%

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsis trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(e) Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortzimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortzimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur .

(f) Zhvleresimi

Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënien e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivet e zhvlerësuara në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuara skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivit ose e njësive të tij të gjenerimit të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(g) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenziemve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjate aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar ne planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.

Leja e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi qe të ketë nxjerrje të flukseve të

ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

(j) Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marrjen e përfitimeve.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri.Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet te ofruara.

(k) Pagesat per qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten më kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet kostos së aktivit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përvec rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(o) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojne në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.

5. MJETE MONETARE

Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	Lekë	*Lekë*
Banka ALL	*119,938,192*	*132,889,379*
Arka ALL	*13,651,708*	*212,472*
Totali	**133,589,900**	**133,101,851**

6. TË ARKËTUESHME NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Në kërkesat e arkëtueshme janë paraqitur të drejtat të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit .

Gjendja e të drejtave të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kliente	*2,946,623*	*23,130,184*
Totali	**2,946,623**	**23,130,184**

7 .TE ARKETUESHME NGA NJESITE EKONOMIKE BRENDA GRUPIT

Në kërkesat e arkëtueshme janë paraqitur të drejtat të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të drejta te tjera nga mardheniet me palet e lidhura.

Te arketueshme nga aktiviteti i shfrytezimit :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Kid zone shpk	*30,267,540*	*71,552,928*
ACREM shpk	*10,000*	-
Agrocon Albania shpk	*19,200*	-
Neptun shpk	*3,560,195*	-
Spar Albania shpk	*127,050*	*75,134*
Mane TCI shpk	*1,743,240*	*1,836,919*
Balfin Shpk	-	*30,000*
Albchrome shpk	-	*19,084*
Totali	**35,727,225**	**73,514,065**

(0)

Te arketueshme nga mardheniet brenda grupit :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Neptun	*28,258,673*	
	28,258,673	-

8. TË DREJTA TË ARKËTUESHME TË TJERA

Gjendja e të drejtave të tjera të arkëtueshme paraqitet si meposhte :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Tatim mbi fitimin i parapaguar	-	*192,895*
Paradhenie	*209,940*	*496,316*
Debitore të tjerë, terminalet POS	*2,809,972*	*190,295*
Te drejta ndaj doganes	*39,515*	*0*
Totali	**3,059,427**	**879,506**

9. INVENTAR –LENDE E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Në këtë post është paraqitur gjëndja lendes se pare dhe materialeve te konsumueshme. Gjate vitit 2017 kompania ka bere riklasifikimi i inventarit te imet dhe amballazheve ne Aktive Afatgjata Materiale. Gjendjet e inventarit te imet dhe amballazheve në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Inventar i imet	-	*21,011,840*
Amballazhe	-	*7,698,695*
Totali	-	**28,710,535**

10. INVENTARE-MALLRA

Në këtë post është paraqitur gjendja e inventarit të mallrave, i cili është llogaritur me koston e blerjes në daten e blerjes. Mbajtja e inventarit behet me koston mesatare të ponderuar.

Gjendja e inventarit të mallrave në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshte :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mallra	*260,256,973*	*391,360,026*
Totali	**260,256,973**	**391,360,026**

11. INVENTARE-PARAPAGIME

Në këtë post jane paraqitur parapagimet e kryera per inventare. Gjendja e parapagimit të mallrave në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshte :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Parapagime per inventar	*1,772,642*	-
Totali	**1,772,642**	-

12. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TË SHTYRA

Parapagime dhe shpenzime të shtyra në fund të vitit ushtrimor paraqiten si meposhte .

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime te shtyra (Garancite bankare)	*3,102,232*	*12,156,064*
Shpenzime te shtyra (Sigurmi Jete)	*79,245*	
Totali	**3,181,477**	**12,156,064**

13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Vlerësimi iaktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar është bërë me koston minus amortizimin e akumuluar; sipas Standardit Kontabël Kombëtar Nr. 5 - Aktivet Afatgjata materiale dhe Jomateriale.

	Makineri Pajisje dhe instalime LEK	Mobilje dhe pajisje Zyre LEK	Pajisje Kompjuterike, etj LEK	Totali LEK
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	**59,607,165**	**145,498,156**	**60,540,731**	**265,646,052**
Efektet e riklasifikimeve pas aplikimit te SKK		**28,710,534**		**28,710,534**
Shtesa	2,585,343	6,932,808	973,324	10,491,475
Pakesime				-
Transferime				-
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	**62,192,508**	**181,141,498**	**61,514,055**	**304,848,061**
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	**12,030,947**	**35,141,272**	**16,025,356**	**63,197,575**
Amortizim i vitit	9,649,983	22,120,369	17,411,033	49,181,385
Pakesime				-
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	**21,680,930**	**57,261,641**	**33,436,389**	**112,378,960**
				-
Vlera kontabël neto				-
Gjendja me 31 Dhjetor 2016	**47,576,218**	**110,356,884**	**44,515,375**	**202,448,477**
Gjendja me 31 Dhjetor 2017	**40,511,578**	**123,879,857**	**28,077,666**	**192,469,101**

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë vit ushtrimor kontabël, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime. Gjate 2017 lende e pare dhe materiale te konsumueshme jane cmuar me nje jete te dobishme me te gjate se 12 muaj nga njesia ekonomike dhe jane klasifikuara si AAGJ Materiale ne vleren 28,710,534 Leke.

14. AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE

Vlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në pasqyrën e pozicionit financiar është bërë me koston minus amortizimin e akumuluar; sipas Standardit Kontabël Kombëtar Nr. 5 - Aktivet Afatgjata materiale dhe Jomateriale.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Parapagime për AAJM	*401,400*	-
Totali	**401,400**	-

15. HUA AFATSHKURTER

Në këtë post paraqiten detyrimet e shoqërisë të cilat sipas SKK3, klasifikohen detyrime afatshkurtra që shoqëria ka ndaj Raiffeisen Bank, referuar kontrates se kredise nr.1831 Rep, 779 Kol, date 07.05.2014, me afat 5 vjet. Ky shenim te lexohet sebashku me shenimin nr.20 ne vijim. Detyrimet per hua jane ne afat, sipas kontrates.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Hua Afatshkurter (Raiffeisen Bank)	*9,306,500*	*9,466,100*
Totali	**9,306,500**	**9,466,100**

16. ARKËTIME NË AVANCË PËR POROSI

Në këtë zë paraqiten të drejtat të arkëtuara në avancë nga klientët për veprimtarinë e shfrytëzimit.

	31Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Arketime ne avance nga klientet	*2,383,900*	*2,185,885*
Totali	**2,383,900**	**2,185,885**

17. TË PAGUESHME AFATSHKURTRA PËR AKTIVITETIN E SHFRYTËZIMIT

Në këtë zë paraqiten llogaritë cilat janë të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit në nivelin afatshkurtër:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Furnitore	*460,291,289*	*679,329,559*
Totali	**460,291,289**	**679,329,559**

18. TË PAGUESHME NDAJ NJËSIVE EKONOMIKE BRENDA GRUPIT

Ne kete post paraqiten llogarite e pagueshme qe shoqeria jone ka ndaj paleve te lidhura. Detyrimet jane te ndara ne detyrimet qe kane lindur nga aktiviteti i shfrytezimit dhe detyrimet nga mardhenie te tjera tregtare brenda grupit. Gjendja në datat 31 Dhjetor 2017 dhe 31 Dhjetor 2016 janë si më poshte :

Te pagueshme brenda grupit nga aktiviteti ishfrytezimit :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
ACREM shpk	*545,724*	*201,230*
Alba Trade	-	*5,417,990*
Albchrome shpk	-	*36,855*
Balfin shpk	*2,598,400*	*517,827*
Elektro Service Shpk	-	*44,000*
Kid Zone shpk	*1,857,328*	*152,023*
Mane TCI shpk	*2,059,315*	*965,240*
Neptun Shpk	*6,226,389*	*1,051,700*
Plus Communication Sh.a	*247,436*	*276,420*
Qendra Tregtare Univers (QTU)	*1,265,357*	*561,624*
SPAR Albania shpk	*1,029,293*	*63,604*
Tirana East Gate Shpk	*9,068,445*	*1,250,749*
TOTALI	**24,897,688**	**10,539,264**

Te pagueshme nga mardheniet brenda grupit :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Neptun		*10,219,167*
Balfin	*37,162,370*	*63,300,000*
Ortaku	*6,567,763*	*6,567,764*
Mane TCI		*12,075,000*
TOTALI	**43,730,133**	**92,161,931**

19. TË PAGUESHME PËR DETYRIMET TATIMORE

Në këtë zë përfshihen të gjitha detyrimet që kompania ka ndaj organeve tatimore për t'u paguar në vitin pasardhës.

Sigurime shoqerore	*1,749,275*	*1,355,282*
Tatim mbi te ardhurat personale (TAP)	*351,610*	*270,807*
Detyrime ndaj personelit - Leje Lindje	*136,465*	*73,191*
Tatim i mbajtur ne burim	*39,555*	*35,235*
Shteti TVSH per tu paguar	*16,821,614*	*14,762,907*
Detyrimi per tatimin mbi fitimin	*6,322,051*	*0*
Detyrime te tjera	*5,210,350*	*80,127*
Totali	**30,630,920**	**16,577,549**

20 DETYRIME AFATGJATA NDAJ INSTITUCIONEVE TË KREDISË

Në këtë post paraqiten detyrimet e shoqërisë të cilat sipas SKK3, klasifikohen detyrime afatgjata që shoqëria ka institucioneve të kredisë (shih shenimin nr.15).

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Hua Afatagjate (Raiffeisen Bank)	*5,428,797*	*15,309,061*
Totali	**5,428,797**	**15,309,061**

21. KAPITALI I NËNSHKRUAR

Në këtë post paraqitet kapitali i paguar, nga ortaku i vetem i shoqerise, shoqeria Balfin Shpk.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Balfin Shpk	*86,600,000*	*86,600,000*
Totali	**86,600,000**	**86,600,000**

22. REZERVA TE TJERA

Në këtë post jane paraqitur rezervat e krijuara nga fitimi i realizuar. Gjatë vitit ushtrimor nuk kemi rritje apo zvogelim të tyre.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Rezerva te tjera	*21,106,592*	*21,106,592*
Totali	**21,106,592**	**21,106,592**

23. FITIM/HUMBJA E VITIT FINANCIAR

Në këtë post paraqiten Fitim/Humbja e vitit ashtu si rezulton në pasqyrën e situatës financiare.
Shoqeria ka rideklaruar pasqyrat financiare per vitin 2016 dhe i ka derguar ne tatime me poste ne date 26 Qershor 2018.
Ndryshimet e kryera ne Pasqyrat Financiare te vitit 2016 jane si rezultat i llogaritjes se amortizimit per Aktivet Afatgjata Materiale ne vleren 54,369,580 dhe kane patur nje ndikim **ne rezultatin e vitit 2016** duke kaluar nga nje fitim prej 28,353,926 lekesh ne nje humbje periudhe prej 26,015,654 .

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitim/Humbja e vitit financiar	*45,262,858*	*(26,015,654)*
Totali	**45,262,858**	**(26,015,654)**

24. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Tek rubrika shitjet neto janë pasqyruar të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqerisë që është në fushën e tregtimit të mallrave.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shitjet neto	*1,155,491,065*	*1,075,285,161*
Totali	**1,155,491,065**	**1,075,285,161**

25. TË ARDHURA TË TJERA TË SHFRYTËZIMIT

Në këtë post paraqiten të ardhura të tjera tjera të gjeneruara nga aktiviteti i shfrytëzimit gjatë vitit ushtrimor.

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura te tjera	*231,583*	*105,858*
Totali	**231,583**	**105,858**

26. NDRYSHIMET NË INVENTARIN E PRODUKTEVE TE GATSHME DHE TE PRODUKETEVE NE PROCES

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Mallra te konsumuara	*805,693,409*	*852,422,537*
Totali	**805,693,409**	**852,422,537**

27. SHPENZIME TE PERSONELIT

Shpenzimet e personelit janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzim page	*72,050,347*	*59,133,052*
Shpenzime të sigurimeve shoqërore	*11,256,806*	*9,128,469*
Totali	**83,307,153**	**68,261,521**

28. SHPENZIME TË TJERA NGA VEPRIMTARITË E SHFRYTËZIMIT

Shpenzime te tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimitgjatë periudhës ushtrimore janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime per qera	*66,936,424*	*54,988,440*
Shpenzime Marketing	*21,879,599*	*11,295,884*
Shpenzime mirmbajtje dhe riparime	*3,461,808*	*2,455,273*
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	*4,067,063*	*1,957,914*
Shpenzime per sherbime bankare	*4,608,319*	*4,088,130*
Shpenzime taksa dhe tarifa vendore	*2,191,218*	*2,344,787*
Shpenzime ambjent i perbashket	*17,741,893*	*24,352,231*
Shpenzime energjie elektrike	*7,987,535*	*6,372,166*
Shpenzime per kancelari	*1,504,920*	*1,352,249*
Shpenzime per siguracion	*100,791*	*441,584*
Shpenzime udhetime dhe dieta	*11,690,461*	*1,633,237*
Shpenzime per siguracion	*224,046*	*441,584*
Pastrimi	*944,406*	*881,545*
Shp. per Sherbime	*7,451,146*	*5,268,104*
Shpenzime per taksa dhe Tarifa Vendore	*2,191,218*	*2,344,787*
Penalitete,gjoba,demshperblime	*5,341,095*	-
Te tjera shpenzime rrjedhese	*17,166,285*	*1,841,717*
Totali	**175,488,228**	**122,059,633**

29. SHPENZIMET NGA INTERESI

Ne kete post paraqiten shpenzimet e interesit pergjate vitit 2016 dhe atij 2017 si meposhte:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Shpenzime interesi	*5,003,674*	*7,912,008*
Totali	**5,003,674**	**7,912,008**

30. FITIM (HUMBJET) NGA KURSI I KEMBIMIT

Fitim-humbjet nga kursi i këmbimit rivlerësuar me kursin 132.95 në datën 31 Dhjetor 2017 janë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitim nga kursi i këmbimit	*14,975,666*	-
Humbje nga kursi i kembimit	*(246,661)*	*3,618,606*
Totali	**14,729,005**	**3,618,606**

31. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Shpenzimi i tatim fitimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2017 bazohet në detyrimin për tatim fitimin sipas Legjislacionin Fiskal në Shqipëri. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 eshte 15%. Niveli taksimit per fitimin zbatuar në vitin paraardhës 2016 ka qënë 15%. Përllogaritjet e Tatimit mbi Fitimin për vitin ushtrimor do të jenë sipas detajimeve të mëposhtme:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitim (Humbja) para tatimit	*51,777,804*	*(26,015,654)*
Plus te ardhura te Panjohura Fiskale	-	
Plus Shpenzime te Panjohura Fiskale	*17,497,159*	*173,663*
Fitim (Humbja) fiskale para tatimit	*69,274,963*	*(25,841,991)*
Humbja e Mbartur	*(25,841,991)*	*0*
Fitimi para tatimit	*43,432,971*	*(25,841,991)*
Tatim Fitimi 15%	*(6,514,946)*	-
Fitim (Humbja) Neto	**45,262,858**	**(25,841,991)**

32. PALET E LIDHURA

Shoqëria ka marrëdhënie me palë të lidhura me shoqërinë mëmë (Balfin sh.p.k) dhe kompanitë e grupit. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në rrjedhën normale të biznesit. Këto transaksione janë kryer në terma tregtare dhe në normat e tregut.

33. NGJARJE PAS DATES SE BILANCIT

Pas datës së bilancit kontabël nuk kanë ndodhur ngjarje që kane ndikuar në rezultatin financiar të vitit ushtrimor.

Tirane me 5 Maj 2018

Eva Kallavaresi

Administratori

Sonila Kashahu

Drejtori i Financës

FASHION GROUP ALBANIA sh.p.k K51914011O